



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:066305

Datë: 26.09.2023

Numri i dokumentit: 04719193

SCC-11-0267

Paditësi

M Sh dhe E Sh, Prizren

Kundër

Të paditura

KBI “**P E**”–Prizren, përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishtë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga gjyqtarja kryesuese Hajrie Shala dhe gjyqtarët Bajram Miftari dhe Diellza Hoxha anëtarë, pas vendimmarrëse të mbajtur me 26 shtator 2023, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M
PËR MOSPARAQITJE**

- 1. Padia e paditësve hedhet poshtë.**
- 2. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt. 09.11.2009 paditësit kanë parashtruar padi për vërtetim të pronësisë, kundër KBI “**P E L – B**” në P pranë Gjykatës Komunale në Prizren. Në ankesë kanë kërkuar vërtetimin e pronës ku paraardhësi i paditësve **A Sh** ka qenë pronarë e ½ pjesës ideale të patundshmërisë e cila gjindet në vendin e quajtur “**Sh-V**”, në sipërfaqe prej 7607 m2 e evidentuar me nr. e njësisë **P-....** e regjistruar në çertifikatë mbi të drejtat e pronës së palujtshme pran zyrës Kadastrale në Prizren. Së bashku me padi janë të bashkëngjitura kontrata mbi shitblerje me numër 11647/478 e dt.

07.11.1963, e cila është e vërtetuar nga gjykata, Aktvendimi mbi trashëgiminë me numër 349/05 e dt. 29.12.2005, kopja e skicës së pronës kontestuese e dhënë nga eksperti me dt. 20.12.2001 e cila mban nr. C.nr.670/94, kopja e certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme, kopja e certifikatës së lindjes së S Sh, kopja e certifikatës për M Sh, kopja e certifikatës për E Sh, kopja e Aktgjykimi nr. C.nr.670/94.

Me dt. 25.11.2011, Gjykata Komunale e Prizren për shkak të inkompetencës e dërgon lëndën pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme e cila mori numrin SCC-11-0267.

Me dt. 26 prill 2023, e paditura AKP parashtrori përgjigje ndaj urdhërit të gjykatës ku theksoi se e kundërshton padinë dhe pretendimet e paditësve si të pa bazuara në ligj. Padia është parashtruar në kundërshtim me parimin procedural “legjitimacion ad causam”, pasi që paditësve ju mungon legjitimiteti aktiv për procedim të çështjes gjyqësore, kjo nga fakti se paditësit nuk kanë prezantuar dëshmi të besueshëm se janë trashëgimtarë. Në rastin konkret paditësi nuk ka prezantuar as një provë materiale përmes të cilës do të dëshmohej legjitimiteti aktiv. Mbi këtë bazë e paditura gjen se padia e paditësve duhet të refuzohet si e pa themeltë. Me tutje në përgjigjen e AKP thuhet se, paditësit nuk kanë ofruar dëshmi se janë bashkëpronarë të parcelës kontestuese. Pra sipas mbrojtjes, kërkesëpadia është e pa themeltë në kuptim të nenit 399.2 të LPK-së, pasi faktet në të cilat mbështetet padia janë në kundërshtim me provat të cilat i kanë propozuar paditësit. Andaj e paditura ka propozuar që kërkesë padia e paditësve të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Arsyetimi ligjor

Padia e paditësve hedhet poshtë.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Neni 58.2 i Ligjit për Dhomën e Posaçme parasheh:

Nëse parashtruesi i ftuar sipas rregullit nuk paraqitet në seancë dëgjimore apo nëse braktis procedurat, atëherë gjyqtari(ët) gjegjës mund, pas parashtrimi të kërkesës nga pala kundërshtare, të nxjerrë një Aktgjykim për mosparaqitje kundër Parashtruesit duke hedhur poshtë kërkesën dhe duke urdhëruar Parashtruesin që të paguajë të gjitha shpenzimet procedurale.

Me 18 maj 2023, Dhoma e Posaçme ka mbajtur seancë dëgjimore në këtë çështje juridike. Paditësit me dt. 17.05.2023 përmes parashtrësës kanë kërkuar që seanca të shtyhet për një afat të caktuar e arsyeshëm në mënyrë që ti mundësohet angazhimi i përfaqësuesit – avokatit profesional dhe po ashtu si sigurojnë aktvendimin e trashëgimisë. Gjykata aprovoi kërkesën e paditësve dhe seancën e radhës e caktoi për dt. 20.09.2023.

Me dt. 20.09.2023 në orën 9.30, Dhoma e Posaçme ka mbajtur seancën dëgjimore në këtë çështje juridike. Gjykata ka pritur paditësit në sallën e gjykimit mirëpo, ata nuk u paraqitën në seancë. Përfaqësuesi i të paditurës – AKP, i propozoj gjykatës që në përputhje me neni 58 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të nxjerrë aktgjykim për mosparaqitje.

Gjykata konstaton se paditësit dhe e paditura janë ftuar në mënyrë të rregullt për seancën e caktuar. Ftesat për seancë paditësve u janë dorëzua 3 muaj para seancës dëgjimore. Të njëjtit kanë pasur kohë të mjaftuar të asistojnë në seancë. Gjykata po ashtu nënvizon se paditësve u është dhënë kohë e mjaftueshme për të angazhuar përfaqësues ligjor dhe për të siguruar prova të nevojshme sipas propozimit të tyre, të njëjtin nuk janë përgjegjur ftesave të gjykatës dhe nuk e kanë arsyetuar mosardhjen andaj, duke pasur parasysh edhe kërkesën e përfaqësuesit të paditurës – AKP, që të merret Aktgjykim për mosparaqitje, kolegji vlerëson se kushtet për nxjerrjen e një aktgjykim të tillë janë plotësuar, ashtu siç janë të parapara në nenin 58.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet kërkesë për prishjen e aktgjykimit për mosparaqitje brenda një muaji nga pranimi i të njëjtit. Kërkesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 59 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hajrie Shala, Gjyqtar kryesues

Bajram Miftari, Gjyqtar

Diellza Hoxha, Gjyqtare